

Neshat Mazaj-Auditues  
L8, Rr « Dibrës » nr. 324, Tirane  
N I P T K 71521007L  
Liçensë Profesionale Nr. 105  
Tel&fax 068 20 79 155  
E-mail:ae.maze@hotmail.com

**RAPORT  
I  
AUDITUESIT TE PAVARUR**

PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE  
TE FONDEVE(KRIJIMIT E PERDORIMIT TE TYRE) TE AKTIVITETIT TE KOMITETIT OLIMPIK  
KOMBETAR SHQIPTAR PER PERIUDHEN 01.01.2008-31.12.2008

---

**KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR**

**T I R A N E**

Ne ekzekutimin e misionit qe me eshte besuar, kam audituar Pasqyrat Financiare te Bilancit Kontabel te “Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar ” per periudhen ushtrimore Janar-Dhjetor 2008 si dhe nje prmbledhje te metodave kontabel te rendesishme dhe shenime te tjera anekse.

**Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e pershtatshme e te sinqerte te ketyre Pasqyrave Financiare** ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Kjo pergjegjesi perfshin ;

- hartimin , venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomali materiale , qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit ;
- per te zgjedhur dhe zbatuar metodat e pershtatshme kontabel ,
- si dhe per te bere çmuarjet kontabel qe jane te aresyeshme per rrethanat e dhena .

**Pergjegjesia e audituesit** eshte qe te shprehe nje opinion per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin e kryer ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te mare siguri te aresyeshme ne se Pasqyrat Financiare jane pa anomali materiale .

Auditimi perfshiu;

- Kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare ne lidhje me fondet e akorduara dhe te shpenzuara.

- Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit , duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare . Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut , audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat , por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te kesaj Organizate .
- Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e çmuarjeve kontabel te bere nga drejtimi me vecorite specifike te saj, si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.
- Auditimi u krye mbi bazen e te gjitha dokumentacionit te disponuar nga kjo Organizate i cili eshte konform rregullave te brendshme te saj dhe dispozitave ligjore aktuale.
- Veprimet financiare te kryera jane te njohura dhe te autorizuar nga organet e drejtimet.Fondet ne dispozicion,ne drejtim te burimit te krijimit dhe destinacionit te perdorimit,jane te pasqyruara me dokumenta ne kontabilitetin dhe pasqyrat financiare te organizates.
- Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare te “Fondeve te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar “ japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte ne drejtim te krijimit dhe perdorimit te tyre per periudhen ushtrimore Janar-Dhjetor 2008, ne perputhje me parimet kontabel dhe standartet nderkombetare te raportimit financiar.

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

Neshat MAZAJ

Tirane 12.02.2009

